

Siguri

Ekskluzive | U identifikua nga kamerat, arrestohet për kanosje 19-vjeçari në Prishtinë – në çantë iu gjet pistoletë me 29 fishekë



Sinjali.com

03 Korrik 2026 12:30



Një 19-vjeçar ka përfunduar në prangat e Policisë së Kosovës, pasi u identifikua si i dyshuar për një rast kanosjeje të ndodhur javën e kaluar në Prishtinë, raporton Sinjali.

Burimet e Sinjalit bëjnë të ditur se bëhet fjalë për E.P, 20-vjeçar, i cili dyshohet se më 25 qershor kishte kanosur A. G., 50-vjeçar, dhe O. G., 18-vjeçar, në rrugën “Bajram Kelmendi”.

Sipas burimeve, pas analizimit të pamjeve nga kamerat e sigurisë dhe veprimeve hetimore, hetuesit e Kryeqytetit kanë arritur ta identifikojnë dhe arrestojnë të dyshuarin mbrëmjen e 2 korrikut, rreth orës 20:30.

Gjatë kontrollit të çantës së tij janë gjetur dhe sekuestruar një pistoletë e tipit “Zoraki 917-T”, kalibër 9 mm, dy karikatorë dhe 29 fishekë të kalibrit 9 mm.

I dyshuari është shoqëruar në Stacionin Policor “Qendra”, ku është intervistuar në praninë e avokatit mbrojtës.

Me urdhër të Prokurorit kujdestar, ndaj tij është iniciuar procedurë për veprat penale “Kanosje” dhe “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, ndërsa është dërguar në ndalim për 48 orë.

Hetimet për rastin janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera